

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th. nga Prizreni Aktakuzës PP./II.nr. **871-3/16** te dt. **12.05.16**, ndaj te akuzuarit S. K. nga fsh. V. KK Suhareke, për shkak te veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, ne prezence te prokurorit shtetit Musli Gashi, dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit te dyte te mbajtur me dt. 14.02.2018 mori publikisht shpalli dhe me date 21.02.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. K., nga i ati H., e ëma H., e lindur G., i lindur me dt. 25.12.1966, ne V., ku dhe tani jeton, me numër personal, i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka te kryer shkollën fillore, i pa pune, i gjendjes se mesme ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se prej datës se pa vërtetuar e deri me dt. 10.11.2015, ne fshatin V., Komuna e Suharekës ne shtëpinë e tij familjare, përfiton nga ndonjë shërbim komunal qe furnizohet përmes rrjetit përçuesit te rrymës apo rrjetit te shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit te autorizuar, në atë mënyrë qe shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor i cili pllombat shtatore i ka te manipuluar (te hapura te mbyllura) ne brendi mbajtjes se poshtëm i diskut është i ndërmarrjes se dëmtuar Keds-i Distrikti ne Prizren, shkakton dem material.

Me këtë ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41,51,52, 73,74 KP si dhe 359 parag. 1 dhe 2,dhe neni 320 KPK-ës të akuzuarit, i shqipton :

D Ë N I M M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim prej 2(dy) muajve si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 100 (njeqindë) euro, të cilat dënime nuk do te ekzekutohen në afatin e verifikimit prej një viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale

Obligohet i akuzuari qe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, **KEDS-i –Distrikti** ne Prizren qe kërkesën pasurore-juridike ta realizoje ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuzë PP./II.nr. **871-3/16 te dt. 12.05.16** ndaj te akuzuarit S. K. nga fsh. V. KK Suhareke, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit te dyte ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Musli Gashi i cili ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuze, qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestar nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsytet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimin.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprën e kryer, është hera e pare qe bie ndesh me Ligjin.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP .
Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 parag, 1 te KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykat